



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER REDI B. SINA
ADRESA FARKE, KOPSHTI
BOTANIK, PALL "SYRI I LIQENIT"
TEL: 697941342

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 10

Tirane më 05/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



V2021051410000543218

REPubLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER REDI B. SINA

DATE 05/01/2021
NR REP 10



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 05.01.2021 (dymije e njezete e nje), perpara meje Noter REDI B. SINA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, FARKE, KOPSHTI BOTANIK, PALL"SYRI I LIQENIT", u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Agim Shaba, atësia Mahmut, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Fag, Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Jahja Ballhysa; Nd. 34; H. 1; Farkë; Farkë E Vogël; 1045; Tiranë, lindur më 08/05/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030831412 dhe nr. personal H70508035P , .

Jonuz Shaba, atësia Mahmut, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Jahja Ballhysa; Nd. 34; H. 1; Farkë; Farkë E Vogël; 1045; Tiranë, lindur më 30/03/1984, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033608160 dhe nr. personal I40330066I , .

Avni Shaba, atësia Mahmut, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Jahja Ballhysa; Nd. 34; H. 1; Farkë; Farkë E Vogël; 1045; Tiranë, lindur më 17/08/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033580360 dhe nr. personal I00817035R , .


Fatlum Shaba, atësia Mahmut, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Fag, Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Jahja Ballhysa; Nd. 34; H. 2; Farkë; Farkë E Vogël; 1045; Tiranë, lindur më 01/06/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034211351 dhe nr. personal H30601153G , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, Akt-Themelimin dhe Statutin e shoqërisë "ÇUNAT E PUTIT" shpk, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
REDI B. SINA



**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ÇUNAT E PUTIT” SH. P. K.**

Ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise”, Ligjit 9723, date 03.05.2007 dhe te akteve te tjera ligjore, sot me daten 22. 01. 2016 , ne themeluesit:

Z.Agim Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Fag Tirane me 08.05.1977, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal H70508035P.

Z.Jonuz Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 30.03.1984, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal I40330066I.

Z.Avni Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 17.08.1980, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal I00817035R, dhe

Z.Fatlum Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Fag Tirane me 01.06.1973, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal H30601153G.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, duke u mbeshtetur ne vullnetin tone te lire , te plote e te sinqerte dhe iniciativen e lire private, ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin 9901, date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare”, ne Ligjin 9723, date 03.05.2007 per Q.K.R.-ne, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojme shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “International Business Development” SH. P. K.

NENI 1

Shoqeria formohet nga ortaket me emrin “ÇUNAT E PUTIT” SH. P. K., emertim qe do te jete i stamposur dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e Shoqerise eshte ne adresen : Tirane Rruga “Jahja Ballhysa” Farke e Vogel Ndertesa nr.34 Hyrja I Kati 1.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj. Njesite e tjera strukturore te Shoqerise si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit, krijojen kur nje gje te tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) LEKE, formuar dhe nenshkruar nga ortaket e shoqerise, duke u zoteruar ne kuota te barabarta nga ortaket ne kete menyre: Zoti Agim Sahaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, Zoti Jonuz Shaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, Zoti Avni Shaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, dhe Zoti Fatlum Shabado te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar. Ortaket kane pavaresi ligjore, ne baze te kuotave qe zoterojne, si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere.

NENI 6

Kohezigjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e njohjes dhe regjistrimit të Shoqërisë si person juridik. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohezigjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Regjistrimit .

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqëria nëpërmjet administratorit të shoqërisë çel llogari bankare në monedhën vendase (Leke) dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributin e tyre përfshirë dhe fondin. Transferimet e kapitalit duhet të vërtetohen me akt notarial. Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sipas tërësive të ditura.

NENI 10

O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie do të jetë :

Import, Eksport, Tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave dhe materialeve të ndryshëm, përfshirë: Materiale elektrike, Materiale Hidrosanitare, Pajisje Elektroshtepiake, Kompjuterë dhe Pajisje Kompjuterike, Celulare, Mjete Transporti, Automjete të çdo lloji (Autovetura, Kamiona, ATV, ATP, etj...), Transporte të brendshme dhe Nderkombëtare, Punime elektrike dhe hidraulike, si dhe Aktivitete në fushën e Ndertimit: Ndertime, Restaurime, Riparime, etj.....

Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj, duke përfshirë edhe veprime për shitblerje sendesh të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

NENI 11

AFATI I VEPRIMTARISE

Aktiviteti privat i Shoqërisë do të zhvillohet me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet .

Kapitali themeltar i Shoqërisë "ÇUNAT E PUTIT" SH. P. K. përbehet nga kontributi fillestar i themeluesve të shoqërisë në vlefën 100 000 (njëqind mijë) Leke.


Kapitali mund të rritet me zhvillimin e veprimtarisë ekonomike financiare të shoqërisë.

NENI 12

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet aktivitetin e saj dhe në drejtime të tjera, të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

NENI 13

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.



NENI 14

Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte dhe Vendimor i Shoqerise, ushtron te gjitha kompetencat qe ligji i njeh Asamblese se Ortakeve te shoqerise. Ata mund t'ia delegojne kompetencat nje ose me shume Administratoreve te caktuar prej tyre, qe do te jene ne kete profesion jo me shume se per 5 (pese) vjet ose dhe nje personi fizik , vetem mbi bazen e prokures.





NENI 15

Administrator i Shoqerise "ÇUNAT E PUTIT " SH.P.K. do te jete **Zoti Agim Shaba**, i cili do te jete administrator i shoqerise per nje periudhe 5-vjecare.

NENI 16

Ky Akt – Themelimi u redaktua ne kater ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtjen dhe vlera te njejta juridike, i cili nenshkruhet regullisht nga ne themeluesit.

THEMELUESIT E SHOQERISE "ÇUNAT E PUTIT" SH.P.K.

JONUZ SHABR Follun Shaba AGIM SHABA
  
Arat Shaba


S T A T U T I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ÇUNAT E PUTIT“ SH.P.K.

Ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise”, Ligjit 9723, date 03.05.2007 dhe te akteve te tjera ligjore, ne themeluesit:

Z.Agim Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Fag Tirane me 08.05.1977, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal H70508035P.

Z.Jonuz Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 30.03.1984, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal I403300661.

Z.Avni Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 17.08.1980, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal I00817035R, dhe

Z.Fatlum Shaba, atesia Mahmut, shtetas shqiptar, lindur ne Fag Tirane me 01.06.1973, banues ne Farke e Vogel Tirane, mbajtes i Leter Njoftimi ID me nr.personal H30601153G.

Hartojme STATUTIN e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “ÇUNAT E PUTIT“ SHPK.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar, “ÇUNAT E PUTIT” SHPK, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 9901, date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise”, Ligjit 9723, date 03.05.2007 dhe te akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesit e shoqerise ne kete sipermarrje kane derdhur kapitalin e tyre, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria “ÇUNAT E PUTIT” SHPK, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane dhe me paisjen me dokumentin perkates nga organi kompetent.

EMRI, QENDRA, TERITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete : Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “ÇUNAT E PUTIT SHPK.

Neni 6

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane Rruga “Jahja Ballhysa” Farke e Vogel Ndertesa nr.34 Hyrja I Kati I.

Neni 7

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

OBJEKTI

Neni 8

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete :

Import, Eksport, Tregti me shumice dhe pakice te mallrave dhe materialeve te ndryshem, perfshire: Materiale elektrike, Materiale Hidrosanitare, Pajisje Elektroshtepiake, Kompjutera dhe Pajisje Kompjuterike, Celulare, Mjete Transporti, Automjete te cdo lloji (Autovetura,

Kamiona, ATV, ATP, etj...), Transporte te brendshem dhe Nderkombetare, Punime elektrike dhe hidraulike, si dhe Aktivitete ne fushen e Ndertimit: Ndertime, Restaurime, Riparime, etj.....

Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajteshme dhe te paluajteshme, pjese marrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 9

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Neni 10

Shoqeria eshte e detyruar te mos e ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare, mund te behet me lejen e organeve perkatese.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 11

Kapitali themeltar i Shoqerise "ÇUNAT E PUTIT" SHPK, perbehet nga kontributi fillestar i themeluesve te shoqerise ne vleften 100 000 (njqind mije) Leke. Kapitali eshte i ndare ne kete menyre : Zoti Agim Sahaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, Zoti Jonuz Shaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, Zoti Avni Shaba do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar, dhe Zoti Fatlum Shabado te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 25 % te kapitalit themeltar.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Neni 12

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt – noterial. Shoqeria apo te tretet, duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditura asaj.

Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te seicilit ortak.

Neni 14

Pjese te kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me pelqimin e ortakëve te shoqerise .

Neni 15

Ne rast te shtimit te numrit te ortakëve, me marreveshje, pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 16

Shoqeria "ÇUNAT E PUTIT" sh.p.k., do te kete si Administrator per nje periudhe 5-vjeçare Zotin Agim Shaba.

Asambleja e Ortakëve te shoqerise ka kompetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut.

Neni 17

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Neni 18

Ne maredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesit e shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administratorit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kompetencen e themeluesve te shoqerise.

Neni 19

Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka ne kompetence :

- . Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6-mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- . Vendas per shperberjen e shoqerise.
- . Vendas per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- . Rregullon maredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.
- . Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shtetore, personave juridike e fizike, vendas a te huaj.
- . E te tjera.

Neni 20

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posaçerisht nga 4 ortaket themelues, te cilet miratojne aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe kane te drejte te informohen personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

Neni 21

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaket e shoqerise. Ne rastin e fundit, shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te asamblese te ortakeve te shoqerise. Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

K R E U II MAREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

Neni 22

Shoqeria "ÇUNAT E PUTIT" SHPK, mund te lidhe kontrata me sektoret shtetore, drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 23

Ne veprimet kontraktuale dhe bankare, shoqeria perfaqesohet prej administratorit ose nga persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 24

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Neni 25

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore, etj. Shoqeria ka te drejte te çele llogari likuiduese prane bankave te vendit, te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likuidimit nepermjet tyre.

Neni 26

Per sigurimin e veprimeve ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne Leke ose valute te huaj.

Neni 27

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj e anasjelltas, mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat te valutes.

Neni 28

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vete shoqeria. Çmimet dhe tarifatat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

Neni 29

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte, shoqeria paguan nje tatim te percaktuar ne dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

Neni 30

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar administratori ose persona te tjere te caktuar nga asambleja e ortakeve, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates te vecante sipas ligjit.

Neni 31

Veprimtaria ekonomike e shoqerise, mbaron ne muajin dhjetor te çdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore sebashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

KREU III
MAREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 32

Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise "ÇUNAT E PUTIT" sh.p.k.

Neni 33

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise regullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise.

Neni 34

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes se juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

Neni 35

Punonjesit e shoqerise, jane te detyruar te respektojne disiplinën e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

Neni 36

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise, zbatohen masa ndeshkimore, te cilat percaktohen nga Asambleja e ortakeve te shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikës se Shqiperise.

Neni 37

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kriterëve te caktuara nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar (Kodin e Punes).

Neni 38

Punonjesit e gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kriterëve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre, sipas Kodit te Punes te Republikës se Shqiperise.

Neni 39

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti te leshuar me shkrim nga Administratori i Shoqerise. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

Neni 40

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te dorezoje detyren ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesiperem mbahet nga administratori i shoqerise.

ELEMENTE TE TJERA

Neni 41

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise, shoqeria mund te marre truall per ndertim, me qira ose ne pronesi, si dhe objekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 42

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimet shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te ortakeve te shoqerise.

Neni 43

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "ÇUNAT E PUTIT" SHPK, caktohen sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Neni 44

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit fillestar ne kapitalin baze.

Neni 45

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 46

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyhen te gjitha detyrimet, i kalon ortakeve te shoqerise.

Neni 47

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakeve pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundeshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 48

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket themelues, vendosin brenda 4 (kater) muajve nga dita e konstatimit, mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkojne prishjen e saj.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 49

Themeluesit, ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve, kane te drejten te bejne ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartojne dhe kontraten e perbashket me ortaket e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne Qendren Kombetare te Regjistrimit ne Tirane.

Neni 50

Mosmareveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten kur kjo nuk arrihet, do te zgjidhen ne Gjykatat kompetente.

Neni 51

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet Ligjit Nr. 9901, date 14 Prill 2008 "Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise", Ligjit 9723, date 03.05.2007 dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 52

Statuti perpilohet ne kater kopje per t'ju dorezuar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ÇUNAT E PUTIT" SHPK.

ORTAKET E SHOQERISE

JONUZ SHABA Fatlum Shaba

A Gjin Shaba

Arta Shaba

[Signature]

[Signature]